



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL (i përmbledhur)¹

Tiranë, më 23.11.2020, ora 11.00

Drejton mbledhjen

Vitore Tusha – Zv/Kryetare e Këshillit

Rendi i Ditës :

- 1. Miratimi i procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes të KED-së të datës 02.11.2020.*
- 2. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019:*
 - Eugen Papandile,
 - Zhaklina Peto.
- 3. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datat 27.09.2019 dhe 24.09.2020:*
 - Aleksandër Toma,
 - Altin Binaj,
 - Eugen Papandile,
 - Ilir Haznedari,
 - Orkida Totojani.
- 4. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datat 21.08.2019 dhe 24.09.2020:*
 - Altin Binaj,
 - Ilir Haznedari.
- 5. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatëve të mësipërm.*

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Marrin pjesë :

- | | |
|----------------------------|---------------------------|
| 1. Vitore Tusha | (zëvendëskryetare) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 5. Saida Dollani | (anëtare) |
| 6. Ludovik Dodaj | (anëtar) |

Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm:

- 1. Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca.**

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

- 1. Z. Bledar Dervishaj**, përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
- 2. Znj. Mimoza Arbi**, përfaqësuese me autorizim e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

HAPET MBLEDHJA

Vitore Tusha hap mbledhjen dhe bën me dije rendin e ditës, i cili është publikuar në përputhje me procedurat dhe aktet e miratuara nga Këshilli. Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Komunikon se anëtarja e këshillit znj. Fatjona Memçaj ka bërë prezent se për arsye shëndetësore nuk mund të jetë e pranishme, pasi ka shfaqur shenja të infektimit me covid-19. Nuk është njoftuar anëtari zëvendësues, sepse nuk ka të tillë për znj. Memçaj.

Anëtarët shprehen se janë dakord me rendin e ditës.

Vitore Tusha shprehet se kuorumi minimal për zhvillimin e mbledhjes plotësohet dhe për sa kohë anëtarët nuk shprehën ndonjë rezervë, vazhdon me rendin e ditës.

Vë në dijeni Këshillin në lidhje me kërkesën e kandidatës znj. Zhaklina Peto, e cila ka konkurruar në vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019. Kjo kandidatë, ditën e enjte, ka paraqitur një kërkesë për përjashtimin e relatores së vakancës së saj znj. Miranda Andoni, kërkesë që në përputhje me kompetencën e zv/kryetarit, në vijim të marrjes dhe ushtrimit të kompetencave të kryetarit, është shqyrtuar dhe është rrëzuar, pasi është vlerësuar se nuk kishte konflikt interesi. Ky vendim i është komunikuar kandidatës në rrugë elektronike dhe me postë, si dhe është publikuar në faqen zyrtare.

Informon Këshillin në lidhje me thelbin e kërkesës për përjashtim, që lidhet me faktin se kandidatja ka paraqitur ankesë në ILD për shkelje disiplinore ndaj relatores dhe për këtë shkak ajo duhej të përjashtohej.

Ditën e mbledhjes kjo kandidatë i është drejtuar Këshillit me kërkesë, ku kërkon përjashtimin e relatores znj. Miranda Andoni, si dhe përjashtimin e zv/kryetares znj. Vitore Tusha nga kjo procedurë, pezullimin e kësaj mbledhje në lidhje me shqyrtimin e vakancës së saj, si dhe ribërjen e shortit për këtë vakancë.

Sjell në vëmendje se vakanca nuk ka vetëm një kandidat, por disa të tillë, dhe se Këshilli duhet të diskutojë në lidhje me këtë situatë. Kërkon të mos marrë pjesë dhe të paktën të diskutohet në lidhje me kërkesën për përjashtimin e zv/kryetares, pasi të njihen me vendimin në lidhje me rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e relatores, znj. Miranda Andoni. Sipas rregullave, kur nuk është zv/kryetari, mbledhjen e drejton anëtari më i vjetër në moshë.

Saida Dollani pyet se cila është baza ligjore.

Vitore Tusha sugjeron se mund të ketë edhe një zgjidhje tjetër, që të vazhdohet me rastet e tjera dhe kur të vijë rasti të shqyrtohet si një çështje e lidhur ngushtësisht.

Saida Dollani shprehet se është dakord për të ecur sa më shumë me rendin e ditës dhe me gjëra që janë shumë më të rëndësishme për vendin.

Anëtarët shprehen se janë dakord.

Vitore Tusha vazhdon me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes së KED-së të datës 02.11.2020. Sqaron se ai u është bërë prezent të gjithëve dhe vërejtjet janë reflektuar.

Anëtarët nuk kanë komente dhe procesverbali i përmbledhur i mbledhjes së datës 02.11.2020 miratohet.

Vitore Tusha vijon me pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin Eugen Papandile për vendin vakant, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019. I jep fjalën relatores Miranda Andoni për të paraqitur relacionin përkatës sipas procedurës.

Miranda Andoni fillon relatimin dhe sqaron se për këtë kandidat raportohet për herë të dytë për gjetjet në procedurën për këtë vakancë. Sqaron se herën e parë është shqyrtuar relacioni për gjetjet në procedurë dhe KED-ja ka marrë vendimin nr. 35, datë 09.10.2020, ku ka vendosur ndalimin e kandidimit. Ky vendim është kundërshtuar prej kandidatit në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. 91, datë 06.11.2020 ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 35, datë 09.10.2020 të KED-ës, duke lënë edhe detyrat përkatëse. Është paraqitur në relacion në mënyrë të përmbledhur, ku konsiston arsyetimi i Gjykatës së Apelit Administrativ në shfuqizimin e vendimit të KED-ës.

Lexon relacionin. Sqaron se kandidati në lidhje me përmbajtjen e shkresave të KED-së dhe përgjigjeve të ardhura ka dhënë parashtrimet, të cilat janë përfshirë në relacion, ashtu si vetë kandidati i ka shprehur me e-mail, pa përjashtuar asnjë paragraf. Sqaron edhe se ky relacion i është komunikuar kandidatit dhe se ai ka dijeni për ditën e mbledhjes.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje nga anëtarët dhe Avokatja e Popullit.

Erinda Ballanca pyet në lidhje me përgjigjen e ardhur nga institucioni i Tatimeve që ka referuar që i vetmi regjistrim i personit është ky aktual? Mos e kanë kuptuar gabim pyetjen? Rezulton sikur ai nuk ka paguar asnjëherë taksa-tatime, megjithëse ka qenë në gjithë këto institucione shtetërore dhe tregon apo paraqet vetëm statusin aktual. Nga leximi i relacionit lidhur me këtë çështje dukej sikur e vetmja marrëdhënie me tatimet e kandidatit ka qenë kjo aktualja me Gjykatën e Kushtetuese.

Miranda Andoni shprehet se ndoshta duhej të ishte cituar edhe përmbajtja e shkresave të KED-së dhe se përgjigja është në funksion të asaj që është kërkuar.

Vitore Tusha sqaron se pyetjet janë bërë vetëm për periudhën e avokatisë.

Saida Dollani lexon përgjigjen e shkresës nr. 2669, në pikën 4, faqe 19 të relacionit. Nga QKB-ja ka ardhur që nuk rezulton i regjistruar. Kjo është e treta, të katërtën keni atë Drejtorin Tatimore Rajonale Tiranë, po janë në mënyrë shumë të hollësishme.

Miranda Andoni vijon me leximin e dokumenteve. Parashtron se në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve është kërkuar për kandidatin Eugen Papandile nëse figuron i regjistruar pranë administratës tatimore dhe si është kryer regjistrimi në këtë administratë. Nëse shtetasi Eugen Papandile është çregjistruar si subjekt fizik dhe nëse është rasti si është kryer kjo mënyrë çregjistrimi. Përgjigjja, pas verifikimeve të kryera, është se shtetasi Eugen Papandile rezulton i regjistruar si administrator në entin publik Gjykata Kushtetuese në datën 04.01.2018 e në vazhdim bashkëlidhur lista e subjekteve e personave të lidhur për informacionin e përgjithshëm e tjerë. Gjithashtu, rezulton i regjistruar si individ për deklaratën, është kjo e DIVES nga verifikimi rezulton detyrime në kohë reale, është një lloj gjobe, pra për DIVEN. Ndërsa për sa i përket regjistrimit, kjo nga Gjykata Kushtetuese, nga data 04.01.2018 e në vijim.

Erinda Ballanca shprehet se është e qartë, përgjigja që ka ardhur nuk i përgjigjet pyetjeve që duhet të kishim ngritur në kuptim të detyrave të apo problematikave të identifikuar nga vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit.

Vitore Tusha sqaron se në dosje është që detyrimi i fillon që kur ka qenë në Ministrinë e Drejtësisë, kur ka qenë në Gjykatën e Lartë. “Janë të gjitha, ju janë dërguar”.

Erinda Ballanca shprehet se u janë dërguar ditën e premte e kanë bërë maksimumin për të parë çdo element.

Vitore Tusha sqaron se janë dërguar vonë sepse në datën 20 kanë ardhur, është bërë mbledhja e shortit në datën 3 dhe në datën 4 janë çuar të gjitha shkresat standard. Sapo kanë ardhur janë bërë pyetjet, të gjitha janë bërë me urgjencë. Por kjo nuk duhet të thotë që të kapërcehet përmbajtja, cilësia, absolutisht asgjë.

Miranda Andoni sqaron se bashkëlidhur shkresës ka një ekstrakt të historikut të punonjësit dhe këtu përfshihet që nga cili moment figuron kandidati si tatimpagues.

Erinda Ballanca, ndonjëherë i regjistruar ne sistemin tatimor si i punësuar, d.m.th a rezulton se ai ka qenë i punësuar në çdo institucion.

Miranda Andoni përgjigjet se si avokat nuk ka asnjë të dhënë.

Vitore Tusha ndërhyt dhe shprehet se nuk ka asnjë të dhënë as nga QKB-ja, as nga Tatimet.

Miranda Andoni sqaron se është pjesa ku ai ka punuar në institucione, si privat nuk ka.

Erinda Ballanca shprehet se: “Unë duke ditur historikun duke ditur se si kemi punuar të gjithë vetë, në vitet që ai ka punuar në këtë shoqatë sepse diskutohet për vitet e avokatit nuk po diskutohet për pjesën tjetër, gjej me vend të bëj parashtrimin e mëposhtëm. Në gjykimin tim, argumenti lidhet me llogaritjen e periudhës së veprimtarisë së tij si avokat dhe a kualifikohet kjo periudhë si eksperiencë pune për qëllim të kërkesave për të qenë kandidat në Gjykatën Kushtetuese. Është për sa i përket pjesës që ai ka qenë avokat. Si avokat, ai është i deklaruar në Dhomën e Avokatisë, ndërkohë marrëdhënien e tij të punës e pretendon që nuk e ka si person fizik, nuk pretendon ai që unë jam i regjistruar si person fizik në një moment të caktuar kohor, dhe duke qenë i tillë, ai pretendon se unë marrëdhënien time e kam pasur si një i punësuar por kam pasur të drejtën e ushtrimit të aktivitetit për një për dy për tre vite. Nga ajo që kuptoj unë, nuk ka qenë i deklaruar si person fizik por mënyra e ushtrimit të aktivitetit është e ndryshme. Një nga format që ju njihet avokatëve për të ushtruar aktivitetin është edhe forma shoqëria tregtare apo edhe ajo e punësimi. duke pranuar të marrin një pagesë fikse pavarësisht nëse e kanë të drejtën e përfaqësimit në gjykatë për efekt të çështjeve të tjera. Pyetja që unë doja të sqaroja ishte: “Nga përgjigjet e institucioni që ai ka punuar pretendohet se nuk ka paguar tatimet por është i regjistruar në sigurimet shoqërore. Ka ndonjë provë në lidhje me këtë çështje?”

Miranda Andoni sqaron se përgjigjja e Grupit Shqiptar është e shoqëruar me kopje të fletëve të librezës së punës. Por nga kopja e librezës rezulton jurist nga 1 janar 2001 - 31 dhjetor 2001. Për periudhën 1 janar 2002 - 31 dhjetor 2002 te DRSSH-ja Tiranë ka pagim vullnetar. Nuk ka gjë tjetër, pastaj në 6 janar 2004 e në vijim rezulton në Ministrinë e Drejtësisë. Këto rezultojnë në librezë.

Vitore Tusha ndërhyt dhe shprehet se për sa kohë Gjykata e Apelit ka vënë detyra, janë respektuar ato. Gjykata e Apelit kërkon një hetim më të thelluar në këtë drejtim. Pyet nëse ka pyetje të tjera.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe pyet në lidhje me procedurën. Meqenëse Gjykata e Apelit ka trajtuar dhe ka lënë detyrën dhe në lidhje me vendimmarrjen për sa i përket kriterit tjetër të çështjes së votës. Ky hetim do të trajtojë vetëm elementin e këtij kriteri për të cilën ka pasur shumicë negative, shumicë që e ka rrëzuar kandidatin apo do të trajtohet dhe kriteri tjetër për të cilin nuk rezulton të këtë pasur sipas asaj që thotë Gjykata e Apelit vendim negativ.

Vitore Tusha sqaron se relacioni u është vënë në dispozicion të gjithëve nga ku rezultojnë të gjitha materialet që janë prezantuar dhe gjithë hetimi që është bërë, bashkë me gjetjet.

Erinda Ballanca pyet nëse kërkimi është thelluar për të dy kriteret apo për njërin nga kriteret.

Miranda Andoni sqaron se për të dyja, meqenëse Gjykata e Apelit e ka trajtuar edhe këtë kriter, relacioni mban edhe kriterin tjetër. I është kërkuar kandidatit të shprehë qëndrimin për këtë

lidhur edhe me vjetërsinë, edhe me integritetin dhe ai është shprehur në qëndrimin përfundimtar edhe për integritetin.

Vitore Tusha vijon me rendin e ditës, shqyrtimi i kandidaturës së znj. Zhaklina Peto, kandidate për vakancën e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019. Fton anëtarët të diskutojnë çështjen e ngritur nga kandidatja për paanshmërinë e zv/Kryetares, sepse në lidhje me pretendimin për paanësinë e relatores, zv/Kryetarja ka marrë vendimin, që i është bërë publik edhe kandidates, të pranishmëve dhe është publikuar në faqen zyrtare. Njofton se ajo vlerëson që të largohet nga mbledhja, në mënyrë që anëtarët të marrin vendim në lidhje me këtë kërkesë.

Saida Dollani kërkon fjalën dhe sjell në vëmendje nenin 222 të ligjit nr. 115/2016 dhe lexon dispozitën. Shprehet se duhet të mbahen në konsideratë që të gjitha parashikimet ligjore dhe se zv/kryetari duhet të marrë pjesë në diskutim nëse do ta diskutojë një çështje të tillë, pasi ajo vetë nuk sheh gjë për të diskutuar për shkak se nuk shikon se ku qëndron konflikti i interesit. Nuk ka konflikt interesi sepse është vetë ligji që ka parashikuar se për shkelje procedurale, kandidati i drejtohet gjykatës, që në rast se e rikthen çështjen, pra e shfuqizon vendimin, ne, si Këshill, jemi të detyruar ta shikojmë atë! Kjo qëndron. Ky është një parashikim ligjor dhe ligji nuk e parashikon si një pengesë për të marrë pjesë në rishqyrtim, përkundrazi. Gjithashtu sjell në vëmendje problemin që krijohet nëse dy anëtarët e Këshillit nuk marrin pjesë në diskutim duke theksuar se në këtë rast nuk ka kuorum as për të diskutuar.

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se i ka lexuar me shumë vëmendje të gjitha detajet e kërkesës dhe vlerëson se nuk është në konflikt interesi. Shprehet se nuk është në papajtueshmëri, por në ushtrimin e kompetencave që i janë dhënë që në 1 janar 2020 dhe në ushtrim të detyrës me shumë përpikëri. Thekson se vendimin për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e relatores e ka arsyetuar dhe e ka njoftuar menjëherë, në mënyrë që kandidatja të kishte dijeni për mënyrën e interpretimit të ligjit dhe procedurës dhe se nga kush do të shqyrtohej kandidatura e saj. Fton anëtarët të shprehen, pasi paanësia është një çështje që i përket Këshillit, përtej interesit vetjak. Shprehet se nuk vlerëson se është në konflikt interesi.

Fiona Papajorgji merr fjalën dhe shprehet se nga ana procedurale nuk sheh ndonjë normë që përcakton që anëtarët e Këshillit duhet të shprehen në lidhje me kërkesa të tilla. Neni 225 i ligjit nr. 115/2016 përcakton qartë se kush shprehet në rastet e konfliktit të interesit, por në këtë rast ndodhemi përpara edhe një fakti që Këshilli ka vetëm zëvendëskryetarin. Ajo shprehet se nuk sheh asnjë rast të konfliktit të interesit, papajtueshmërisë apo qoftë edhe të heqjes dorë në veprimtarinë e ushtruar nga znj. Vitore Tusha. Të gjithë kandidatët kanë të drejtën të kërkojnë përjashtimin e anëtarëve të KED-së, si dhe të bëjnë edhe kallëzime të mundshme. Në rastin konkret nuk sheh asnjë nga rastet e parashikuara nga ligji që zv/kryetari dhe anëtarja relatore, apo edhe ndonjë nga anëtarët e Këshillit të ndodhen në situatë konflikti interesi. Anëtarët kanë dhënë një mendim dhe kanë votuar për secilin prej kandidatëve. Nëse vendimi i KED-së do të shfuqizohet nga Gjykata Administrative e Apelit, çka është në diskrecionin e saj, është përsëri Këshilli që duhet shprehet. Kjo nuk përbën rast të heqjes dorë dhe të gjendjes në rast papajtueshmërie për të votuar përsëri. Edhe këtë e ka parashikuar ligji, nuk ka asnjë interpretim tjetër.

Arta Marku shprehet se me vendimin që kanë marrë kanë bërë një interpretim ligjor. Askush nuk e pengon ILD-në të zhvillojë procedimin, askush nuk e pengon prokurorin të bëjë hetimin nëse ka shkelje të veprës penale, të konkludojë, por këtu po diskutohet vetëm nëse ka një konflikt interesi apo jo, qoftë fillimisht me zv/kryetaren, dhe mendon se ka bërë thjesht detyrën. Nuk sheh ndonjë gjë tjetër që zv/kryetarja të ketë konflikt interesi dhe të tërhiqet nga dhënia e mendimit për këtë kandidate.

Miranda Andoni merr fjalën dhe shprehet se e ka dhënë paraprakisht mendimin e saj, në lidhje edhe me kërkesën që kandidatja ka paraqitur për përjashtimin e saj. Shprehet se nuk ka qenë dakord dhe nuk ka konstatuar asnjë dispozitë ku bazohet kërkesa e kandidates për përjashtimin e saj si relatore. Shprehet se nuk është në mosmarrëveshje të natyrës të germës “b” të nenit 224. Kandidatja ka paraqitur një kërkesë për procedimin disiplinor të relatores dhe ky sipas

saj është shkak që relatorja duhet të japë dorëheqjen nga vijimi i mëtejshëm. Arsyet e mosmarrëveshjeve të pretenduara nga kandidatja si një shkak për përjashtimin e relatores, ajo i ka vlerësuar si të pabazuara, madje mendon se kërkesa është abuzive. Edhe për zv/kryetaren, shkak i përjashtimit është pikërisht për qëndrimin e mbajtur në lidhje me kërkesën e përjashtimit të relatores.

Saida Dollani merr fjalën. Shprehet se e shikon shumë më gjerë se kaq kërkesën e zonjës Peto, ankesën që ka paraqitur, pra edhe kërkimet që ka bërë edhe ankimet që ka bërë përpara këtij Këshilli. E sheh të lidhur me pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës që parashikon që gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike me një veprimtari të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës dhe jo më kotë kushtetutbërësi ka bërë këtë dispozitë. Zonja Peto është lektore e së drejtës sipas akteve që ka sjellë dhe prezumohet se duhet ta njohë mirë të drejtën kushtetuese. Ku nga e drejta kushtetuese rrjedhin shumë parime të tjera. Një nga parimet që rrjedh dhe që është shumë e fuqishme në veprimtarinë e të gjithë institucioneve dhe organeve shtetërore është parashikimi i qartë dhe në mënyrë tipike i shkeljeve që bëhen. Në rastin konkret në mënyrë tipike dhe të qartë ligji nr. 115, datë 2016 ka parashikuar që kur ka shkelje të rënda kandidati ankohet në Gjykatën Administrative e cila kur shikon që ka shkelje veçanërisht të rënda, prish vendimin, shfuqizon vendimin dhe e sjell për rishqyrtim çfarë është fakti që ndodhemi para neve sot. Ndërsa për sa i përket pasojave disiplinore janë ato për të cilat ligji parashikon detyrueshmërinë e organit për të vepruar por që nuk zbatohen nga ai dhe nuk i ka vënë vetë pasojat që psh, ku thotë ligji që një veprim duhet të bëhet brenda 15 ditëve, duhet bërë brenda 15 ditëve në të kundërt ka pasoja disiplinore, sepse nuk ka parashikuar pasojë tjetër kështu që ngelet ajo disiplinore. Këtë zonja Peto duhet ta dijë shumë mirë prandaj duke qenë se më lë shumë për të dëshiruar ndaj si anëtare e Këshillit unë ju propozoj që ky ankim dhe kërkim të futen dhe të bëhen pjesë e fashikullit të shqyrtohen për sa i përket edhe kapacitetit të plotësimit të nenit 125 pika 1 dhe 2 të Kushtetutës, nga kandidatja. Ndërsa, për sa i përket relacioneve të ardhura këtu apo sjelljes që kërkon zonja Peto të shikohet për sa i përket zonjës Andoni apo zv/kryetares, unë jam një anëtare e Këshillit dhe si e tillë absolutisht nuk shikoj të tilla gjëra. Nëse do të kishte një fakt që do të më çonte në rrugën penale ku thotë zonja apo në rrugën administrative, të jeni të bindur që do ta bëja detyrën sipas ligjit. Në rastin konkret, nuk shof gjë tjetër përveçse të zbatoj detyrën e anëtarit ashtu sikundër ka vepruar zv/kryetarja dhe anëtarja tjetër e Këshillit dhe ta çojmë përpara këtë procedurë. Ju faleminderit. Ju bëra edhe një propozim, ju lutem të futen të bëhen pjesë e dosjes.

Ludovik Dodaj shprehet se nuk e parashikon ligji dhe nuk mund të ketë mbivendosje pafundësisht për vendimin e zv/kryetares dhe për sa i përket relatores është shprehur në vendim zv/kryetarja, nëse ka rrethana të reja do të shprehet përsëri në vendim zv/kryetarja. Kurse që të bëhen pjesë e procesit, nuk mund t'u kërkojmë anëtarëve ta vëmë ne aty, pasi nuk ka sens. Ajo ankohet për një nga anëtarët, se kështu mendon subjekti dhe duhet t'ia vëmë ne, duhet t'ia relacionosh, duhet t'i bësh relacion duhet ti thuash që ke edhe këto probleme.

Vitore Tusha i jep fjalën Avokates së Popullit.

Erinda Ballanca shprehet se është vënë në dijeni me kërkesën e paraqitur në ditën e sotme. Kërkesa nuk ka të bashkëlidhur ndonjë kallëzim penal, dhe ndërkohë nuk e di nëse në sekretari tash ka mbërritur apo jo? Duket që nuk ka! Duhet bërë verifikimi procedural, për të verifikuar pabazueshmërinë formale në prova të ankesës, sepse kuptohet se çfarë duhet të themi aktualisht është e shënuar dhe lidhet me orën apo kohën që kemi zhvilluar diskutimin e kësaj çështjeje në mbledhje. Për sa i përket asaj pike (shkakut të paraqitjes së një kallëzimi penal) mendoj se vetëm thënia e palës, pa dokumentin provues bashkëlidhur që nuk duhet të merret në konsideratë si pretendim sepse është e pabazuar në provë. Dëshira dhe vullneti i palës se në të ardhmen do të bëj diçka, nuk përbën provë. Kur ta bëj do të duhet të vlerësohet! Kjo është në gjykimin tim për sa i përket pjesës së parë si një element tjetër për tu vlerësuar. Për sa i përket pjesës së dytë duket sikur ka një moskuptim, një keqkuptim nga ana e kandidatit në lidhje me

natyrën e organeve administrative dhe vendimmarrjeve të tyre dhe me aftësinë e tyre për ta rimarrë po ata përsëri të njëjtën çështje në shqyrtim. Sa e sa herë gjykatat kthejnë për shkelje procedurale siç është rasti konkret se nuk ka kompetencë për efektin e vendimmarrjes, nëse kthejnë për një shkelje procedurale një praktikë organet tatimore, çdo gjykatë e kthen përsëri tek organi administrativ (që është këshilli), përsëri ai organ administrativ e merr në shqyrtim çështjen. Nuk e merr një organ tjetër, sepse organet administrative janë të përcaktuara. Kjo çështje është trajtuar edhe më parë. ILDKPI-ja kishte marrë më parë një vendim të caktuar, ILDKPI-ja po merr përsëri sot një vendim tjetër. Pra, mbi bazën e provave të paraqitura dhe të dokumenteve do kryhet hetimi përsëri, e nuk përjashtohet mundësia (teorikisht) e një qëndrimi të ndryshëm bazuar në prova. Në rastin konkret, problemi i identifikuar nga gjykata sipas vendimit ka qenë tërësisht procedural në lidhje me një njoftim përsëri për gjetjet që më parë ishte njoftuar, dhe është gjykuar ndoshta, unë skam qenë në atë mbledhje, është gjykuar që kandidatja kishte dhënë të gjitha shpjegimet që ajo kishte në lidhje me atë çështje. Pra, është vetëm ridhënia edhe njëherë e mundësisë, në gjykimin tim për tu shprehur përsëri dhe për ta paraqitur nëse kishte apo jo prova të reja për ato gjetje që kishin rezultuar nga ana e ILDKPI- apo e kriterit pasuror. Në përfundim mendoj se: në lidhje me kërkesën për të kërkuar përjashtim e anëtares, e kryetares në detyrë zonjës Vitore Tusha, kërkesa është tërësisht e pabazuar. Vendimmarrja e saj është në kuptim të ligjit dhe secili ka të drejtën e vetë për të çmuar në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër qëndrimet apo interpretimin ligjor a argumenteve të dhëna në vendim. Nëse ka apo nuk ka ankim për vendimet e KED apo anëtareve të tij kjo lidhet tërësisht me ligjëvënësin dhe me rrugët dhe me mjetet procedurale që kandidati do të duhet ti përdor. Edhe për sa i përket çështjes për përjashtimin e zonjës Miranda Andoni nga kjo procedurë, në gjykimin tim mendoj se, nuk ka shkak ligjor për të bërë përjashtimin e saj nga procedura. Përveç sa më sipër, mendoj se kjo edhe parimisht dhe teorikisht pranimi i kësaj kërkesë do ta bënte të pamundur zhvillimin e detyrës nga ana e KED-së për këto vakanca, duke e çuar krijimin e Gjykatës Kushtetuese në një situatë edhe më të pamundur, duke e vonuar edhe më tej krijimin e Gjykatës Kushtetuese. Kështu që në gjykimin tim, mendoj se ky Këshill duhet të vijojë punën për të trajtuar, për të çuar kandidatët, siç do të ishte edhe rasti. Në ende nuk e dimë nëse për këtë vakancë kemi apo jo numrin e kandidatëve për të vijuar në mënyrën e duhur procedurën sepse nuk ka akoma vendimmarrje përfundimtare. Dhe në këtë pikë duket sikur është një shtyrje në kohë për të mos lejuar këtë Këshill për të marrë një vendim në lidhje me një kandidaturë të caktuar. Unë nuk e shikoj se kjo është një mënyrë legjitime apo të themi një rast legjitim për të garantuar të drejta të caktuara të ndonjërit prej kandidatëve, vënë kjo edhe në balancë me nevojën e vendit për një gjykatë funksionale. Faleminderit !

Vitore Tusha shprehet se kandidatja Zhaklina Peto ka paraqitur edhe kërkesë për të pezulluar shqyrtimin e kandidaturës së saj dhe kërkesë për të bërë short të posaçëm për relatorin për kandidaturën e saj. Fton anëtarët të japin qëndrimin e tyre në lidhje me këto kërkesa.

Fiona Papajorgji shprehet se çështjet janë të lidhura, por meqenëse duhet një mendim i shprehur, nuk mendon se gjenden në kushtet e pezullimit të procedurës dhe të bërjes së një shorti të ri.

Arta Marku ndan të njëjtin mendim. Nuk ka arsye, përderisa nuk është pranuar kërkesa për përjashtimin e relatores edhe kërkesën tjetër e sheh si të paarsyeshme për ta diskutuar këtu.

Miranda Andoni shprehet se meqenëse kërkesa për pezullim nga kandidatja është e lidhur me përjashtimin e relatores dhe të zëvendëskryetares, të cilat nuk janë pranuar deri në këto momente, ka mendimin të mos pranohet kjo kërkesë për pezullim.

Saida Dollani merr shkas nga fjala e Avokates së Popullit, dhe shprehet se ankimi është një e drejtë dhe si e tillë duhet të parashikohet nga ligji. Ligji nuk parashikon të drejtën e ankimit në Këshill as për sa i përket vendimit të zv/kryetares për përjashtimin, çka shkon bashkë me vendimin dhe kandidatja ta ankimojë nëse nuk do të jetë e kënaqur nga vendimmarrja e këtij Këshilli dhe së dyti po ashtu nuk parashikon ligji të jesh apo të ankoresh për hedhjen e shortit për relatorin. Ligji ka parashikuar tjetër procedurë, kur ka papajtueshmëri. Prandaj e përfundon fjalën

duke theksuar se nuk i merr në konsideratë ankesat apo kërkesat e paraqitura, duke u shprehur se nuk e parashikon ligji, nuk ka çfarë të them.

Ludovik Dodaj shprehet se nuk duhet marrë në konsideratë, pasi nuk ka bazë ligjore.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se nuk e gjen të bazuar kërkesën për pezullimin e procedurës edhe për faktin që e shpjegoi edhe tha më parë arsyet përse procedura ka afate të përcaktuara dhe shkaqe të cilat nuk mund të zhvillohet, janë të përcaktuara shprehimisht në ligj. Edhe mundësia e ndryshimit të relatorit kur ai nuk ka asnjë veprim procedural më për të bërë dhe se i tërë Këshilli ka dijeni për materialet, nuk çon në shtyrjen apo pezullimin e shqyrtimit të kandidaturës, pasi nuk do justifikohet me asnjë veprim tjetër procedural. Nëse anëtarët kanë të tilla kërkesa ato sqarohen dhe parashtrihen në trajtimin e kandidaturës. Nëse do të kishte vend për të shtyrë trajtimin e kësaj candidature, e vetmja gjë për të cilën, në gjykimin tim, mund të kishim diskutim do të ishte nëse ajo do të kërkonte kohë për ta paraqitur dokumente prova, gjëra shtesë në lidhje me provueshmërinë apo me pretendimet që kanë të bëjnë me atë të cilën këshilli ka hetuar, vetëm në këtë rast ne do të sugjerim shtyrjen e procedurës për këtë kandidaturë. Ndërkohë, duke qenë se kam parë edhe përgjigjen që ajo ka për relatoren, duke i bërë ajo pyetje relatores e duke mos sjellë akte apo prova të tjera për të argumentuar para këshillit bazueshmërinë apo të jo të gjetjeve. Në këtë kuadër them, nëse do ta trajtojmë në atë këtë aspekt për ato shkaqe nëse ka apo jo nevojë për një hetim më të thelluar për ato pikëpyetje që janë ngritur në ato shkresa kjo është çështje tjetër por për sa i përket këtij fakti, faktit të kërkesës për përjashtim apo të këtyre fakteve të reja që kanë ndodhur që nga data 30 e deri më tash, mendoj që nuk ka vend për ta pezulluar, as për të hedhur short përsëri.

Miranda Andoni vijon me relatimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto. Sqaron fillimisht se edhe për znj. Zhaklina Peto, relatimi bëhet për herë të dytë, për gjetjet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti në datën 22.11.2019. Kandidatja ka depozituar brenda afatit të caktuar nga Këshilli parashtrimet përfundimtare në lidhje me çështjen dhe bashkëlidhur nuk ka ndonjë dokument mbështetës. I është njoftuar relacioni kandidatës, data dhe ora e mbledhjes për ditën e sotme. Vijon me relatimin e plotë të çështjes sipas relacionit.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje nga anëtarët dhe Avokati i Popullit.

Anëtarët dhe Avokati i Popullit nuk kanë pyetje.

Vitore Tusha vijon me pikën e tretë të rendit të ditës, që është shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët në vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur përsëri në datën 24.09.2020. Në cilësinë e relatores, sipas shortit të datës 20.10.2020, fillon me relatimin e gjetjeve në procedurën e kandidatit Aleksandër Toma. Vijon me relatimin e plotë të çështjes sipas relacionit. Sqaron se relacioni i është komunikuar kandidatit, anëtarëve, Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara, që sipas ligjit u lejohet të marrin pjesë dhe është njoftuar publikisht si pjesë e rendit të ditës në faqen e Gjykatës së Lartë.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje nga anëtarët dhe nga Avokati i Popullit.

Erinda Ballanca shprehet se nuk ka pyetje, por si gjetje ka faktin se në dosje formulari i deklarimit për integritetin e personave është pa datë.

Vitore Tusha sqaron se data e shkresës përcjellëse të Këshillit mund të merret data e procesverbalit që mban sekretaria në momentin që dorëzohet deklarata. Sipas deklaratës rezulton se kandidati është paraqitur pranë zyrës së Këshillit dhe e ka nënshkruar në datën 22.10.2020, ndaj konsiderohet e plotësuar në rregull. Pyet nëse ka pyetje apo sqarime.

Anëtarët dhe Avokati i Popullit nuk kanë pyetje apo sqarime.

Vitore Tusha vijon me relatimin e gjetjeve në procedurën e kandidimit të kandidatit Altin Binaj, i cili ka shprehur interes në vakancën e krijuar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur përsëri në datën 24.09.2020. Sqaron se për këtë kandidat, me vendimin nr. 25, datë 16.09.2020, KED-ja ka vendosur lejimin e kandidimit të tij në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, i shpallur nga Presidenti në datën 22.11.2019. Vijon me relatimin e plotë të çështjes sipas

relacionit. Sqaron se relacioni i është komunikuar kandidatit, anëtarëve, Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara, që sipas ligjit u lejohet të marrin pjesë dhe është njoftuar publikisht si pjesë e rendit të ditës në faqen e Gjykatës së Lartë.

Vitore Tusha pyet nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët dhe Avokati i Popullit nuk kanë pyetje apo sqarime.

Vitore Tusha vijon me relatimin e gjetjeve ne procedurën e kandidimit të kandidatit Eugen Papandile, i cili ka shprehur interesin në vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur përsëri në datën 24.09.2020. Relaton procedurën e ndjekur. Sqaron se siç është shpjeguar në relacionin shtesë, kandidati ka njoftuar se është tërhequr nga kjo vakancë e shkurtër, pasi nuk u përgjigjet më interesave të tij.

Vitore Tusha pyet nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët dhe Avokati i Popullit nuk kanë pyetje apo sqarime.

Vitore Tusha vijon me relatimin e gjetjeve ne procedurën e kandidimit të kandidatit Ilir Haznedari, i cili ka shprehur interes për kandidim në vakancën e krijuar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur përsëri në datën 24.09.2020. Vijon me relatimin e plotë të çështjes sipas relacionit. Sqaron se relacioni i është njoftuar kandidatit, anëtarëve, Avokatit të Popullit dhe të ftuarve të tjerë sipas ligjit dhe është njoftuar publikisht si pjesë e rendit të ditës në faqen e Gjykatës së Lartë.

Vitore Tusha pyet nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët dhe Avokati i Popullit nuk kanë pyetje apo sqarime.

Vitore Tusha vijon me relatimin e gjetjeve në procedurën e kandidimit të kandidatës Orkida Totojani, e cila ka shprehur interes për kandidim në vakancën e krijuar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur përsëri në datën 24.09.2020. Relaton në lidhje me procedurën e ndjekur dhe informon se me e-mailin e datës 11.11.2020 kandidatja ka dërguar kërkesën për heqje dore nga kandidimi për arsye personale. Sqaron se relacioni i është njoftuar kandidatit, anëtarëve, Avokatit të Popullit dhe të ftuarve të tjerë sipas ligjit dhe është njoftuar publikisht si pjesë e rendit të ditës në faqen e Gjykatës së Lartë.

Vitore Tusha pyet nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët dhe Avokati i Popullit nuk kanë pyetje apo sqarime. Vullneti i kandidatit është shprehur qartë.

Vitore Tusha vijon me pikën e 4-t të rendit të ditës, shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatëve për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018, rishpallur në datën 21.08.2019 dhe rishpallur përsëri në datën 24.09.2020. I jep fjalën relatores, znj. Saida Dollani.

Saida Dollani fillon relatimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatit Altin Binaj. Sjell në vëmendje një hap procedural bazuar në nenet 11 dhe 18 të Kodit të Procedurës Administrative, dispozitë që në mënyre eksplicite parashikon procedurën jo burokratike dhe efeciente në ecurinë administrative të një procesi. Për këtë arsye ka vendosur që të marrë të gjithë vendimin e mëparshëm të lejimit të z. Altin Binaj dhe ta bëjë pjesë të dosjes së kandidimit. Vijon relatimin e plotë të çështjes sipas relacionit.

Vitore Tusha pyet nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët dhe Avokati i Popullit nuk kanë pyetje apo sqarime.

Vitore Tusha i jep fjalën relatores Saida Dollani për relatimin e kandidaturës tjetër.

Saida Dollani merr fjalën dhe fillon me relatimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatit Ilir Haznedari. Sqaron se është i njëjti relacion i përcjellë nga znj.Tusha për vakancën ku është relatores. Vijon relatimin e plotë të çështjes sipas relacionit.

Vitore Tusha pyet nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët dhe Avokati i Popullit nuk kanë pyetje apo sqarime.

Bledar Dervishaj, pasi mbyllet relatimi edhe për këtë kandidat të fundit, kërkon fjalën dhe dëshiron të adresojë një pyetje drejtuar anëtarëve të KED, kryesisht dy relatorëve të vakancave të parakohshme (një e Presidentit dhe një e Kuvendit të rishpallura në datën

24.09.2020). Duke qenë se sot u relatua për një pjesë të kandidatëve që kanë aplikuar për këto dy vakanca, dhe ende kanë ngelur disa kandidatë në proces verifikimi, në çfarë faze procedurale ndodhet verifikimi i këtyre kandidatëve, nëse është administruar informacioni i plotë nga institucionet e treta? Apo informacioni është administruar i plotë dhe pritet të bëhet vlerësimi nga relatori i vakancës?

Saida Dollani përgjigjet se për kandidatin e vakancës ku ajo është relatore shumë shpejt do t'i paraqesë relacionin zv/Kryetares, me qëllim dërgimin e çështjes në mbledhje, pasi kanë ardhur edhe shpjegimet e kandidatit.

Vitore Tusha shprehet se të dyja relatoret kanë punuar me të njëjtin ritëm dhe shpejtësi. Sqaron se kandidaturat e ngelura janë në faza të ndryshme, për shkak të specifikave që ka secili kandidat. Për tre kandidatë ka qenë dita e fundit e dhënies së shpjegimeve mbi gjetjet dhe në vijim do të paraqitet relacioni i plotë në lidhje me ta. Ndërkohë për dy kandidatë nuk është përfunduar ende procedura e verifikimit. Sa më shpejt, do thirret mbledhja e radhës e Këshillit, brenda kësaj jave. Pyet përfaqësuesin e Presidentit nëse sqarimi është i plotë.

Bledar Dervishaj shprehet se përgjigja e dhënë është ezauruese. Ai shprehet gjithashtu se, nisur nga koha e shkurtër që kanë marrë deri më tani shqyrtimi i kandidatëve i këtyre dy vakancave që janë rishpallur nga të dy organet e emërtesës (Presidenti dhe Kuvendi) në të njëjtën ditë (24 shtator 2020) konstatohet se, kur ekziston vullneti në KED, por njëkohësisht dhe kur Këshillit i përgjigjen në kohë institucionet e treta për dhënien e informacionit të kërkuar, atëherë bëhet e mundur si në rastin konkret që brenda një kohe kaq të shkurtër 5 (pesë) kandidatë të kalojnë në filtër, ndërkohë që tashmë presim përfundimin e procesit të verifikimit edhe të 5 kandidatëve të tjerë.

Vitore Tusha deklaron mbylljen e mbledhjes për të vijuar me pikën tjetër të rendit të ditës, procedurën e vendimmarrjes për kandidatët.

Mbledhja mbyllet në orën 13:15

Tiranë, më 23.11.2020

SEKRETARE

Zv/KRYETARE

Ermelinda KADIU

Vitore TUSHA

Elona KARDHIQI

Vilma DOKUSHI

ANËTARE

Arta MARKU

ANËTARE

Fiona PAPAJORGJI

Zv/KRYETARE

Vitore TUSHA

ANËTAR

Ludovik DODAJ

ANËTARE

Saida DOLLANI

ANËTARE

Miranda ANDONI

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Elona KARDHIQI

Vilma DOKUSHI